



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 6446 Prot

Maliq më, 9.12:2021

NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma a, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.826, datë 21.11.2012 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pirg të Qarkut të Korçës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” i ndryshuar, Kreu I pika 5, Kreu II pika 1 dhe 3, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 18, datë 03.03.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr.71, datë 30.09.2016 “Për miratimin e listave të tokave bujqësore të pandara me qëllim dhënien me qira të tyre, për Njësitë Administrative Pirg, Vreshtas dhe Pojan të Bashkisë Maliq” i ndryshuar”;

Bashkia Maliq, njofton se jep me qira tokën bujqësore të pandarë me ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, me Numër Pasurie 473, Zonë Kadastrale 2028, Sipërfaqe 24700 m², Fshati Kakaç, Njësia Administrative Pirg.

Të interesuarit të paraqesin kërkesat e tyre pranë Bashkisë Maliq, brenda datës **20.12.2021**.

Ankandi për dhënien e tokës me qira do të zhvillohet në datën **07.01.2022**, ora **10:00**, pranë Bashkisë Maliq.

KRYETAR I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU



Nr. 120 Prot